



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Prijemno / Predato Received / Delivered	07.08.2023	3	viti god. year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org. / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKP/MS/SHK	5561/2023		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.895/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.895/2023 të datës 30.06.2023 të parashtruar nga ankuesi [redacted] kundër Vendimit KD.nr.28/2023 të datës 31.05.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, në çështjen juridike "Masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafi 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 07.08.2023, mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.895/2023 e datës 30.06.2023 e parashtruar nga ankuesi
- II. Anullohet Vendimi KD.nr.28/2023 i datës 31.05.2023 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës.
- III. Obligohet Drejtor i Përgjithshëm i Shërbimit Korrektues të Kosovës dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimit të bëjë zbatimin e këtij vendimit, duke bërë kompensimin e pagës së ndaluar për ankuesin sipas vendimit si në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi dhe të bëjë shuarjen e masës disiplinore ndaj ankuesit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Zëvendësuesi i Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit në Prizren, më datë 12.04.2023 ka nxjerr Urdhër për Fillimin e Hetimeve duke e themeluar komisionin prej tre anëtarëve me qëllim të hetimit të zbardhjes së rastit të pranimit të detyrës respektivisht armës dhe municionit MP-5. Komisioni prej tre anëtarëve më datë 13.04.2023 ka përgatitur raport me të cilin konstatohet se gjatë pranimit të detyrës në këtë rast ka pasur shkelje pasi që nuk është verifikuar nëse pranimi i armës është bërë në rregull ngase dy fishek të armës kanë qenë të dëmtuar ndërsa pranimi është bërë kinse gjithçka është në rregull.

Fillimisht më datë 18.04.2023 nga Zëvendësuesi i Drejtorit të Qendrës së Paraburgimit në Prizren për këtë rast është inicuar procedurë disiplinore ndaj zyrtar R.K, pranë Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, mirëpo Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës, gjatë shqyrtimit të rastit dhe gjatë intervistimit të ankuesit më datë 12.05.2023 ka konstatuar se përgjegjësi në këtë rast ka edhe ankuesi sipas kësaj lënde, kështu që më datë 17.05.2023 nga Kryesuesi i Komisionit Disiplinor është inicuar procedurë disiplinore edhe ndaj ankuesit.

Më datë 31.05.2023 Komisioni Disiplinor i Shërbimit Korrektues të Kosovës ka nxjerr Vendim KD.nr.28/2023 me të cilin ankuesin e ka bërë përgjegjës për shkelje të rënda disiplinore duke i shqiptuar masën disiplinore *"Ndalimi i 20% e pagës për periudhë dy (2) muaj"*.

Ankuesi kundër këtij vendimi, më datë 30.06.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 4976/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimi të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 03.07.2023 ankesën e ankueses e ka proceduar për përgjigje në ankesë në Shërbimin Korrektues të Kosovës. Ndërsa Këshilli, me datë 04.07.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë përmes emailit së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës,ndërsa në këshill është protokolluar më datë 07.07.2023,pasi janë dorëzuar shkresat në kopje fizike në këshill konform kërkesës për përgjigje në ankesë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me rastin e shqyrtimit të kësaj ankesë ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 4976/2023 të datës 30.06.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin KD.nr.28/2023 të datës 31.05.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës; Kërkesën për përgjigje në anesë e datës 03.07.2023; Përgjigjen në ankesë e datës 07.07.2023; Kontratë për kohë të pacaktuar e ankuesit e datë 30.06.2018; Procesverbalin e seancës së Komisionit Disiplinor i datës 12.05.2023;Këkresën për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit e datës 17.05.2023; Urdhrin për fillimin e hetimeve i datës 12.04.2023; Raportin e Komisionit i datës 13.04.2023; Informatën me Nr. 447/2023 e

datës 10.04.2023 e ankuesit; Formularin Zyrtar i Informimit të Ndërrimit me Nr. 445/23 i datës 10.04.2023; Shkresë me titull Vërejtje; Dëshmi për pranim detyrës; Udhëzim për rregullat e punës për oficerin e karakollit në Qendrën e Paraburgimit në Prizren i datës 14.06.2022; Udhëzim për instruksionet e Drejtorit për Stafin me Nr. 50/2022 i datës 11.05.2022; Shkresën për raportim të parregullsive e datës 10.04.2023; Fotot e predhës; Deklaratë me Nr. 446/23 e datës 10.04.2023 nga R.K; Informatën me Nr. 448/223 e datës 10.04.2023 nga K.L; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë për ankuesin i datës 25.01.2022 dhe 12.01.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga ankuesi, është e **bazuar, sepse:**

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit KD.nr.28/2023 të datës 31.05.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës, pretendon që ky vendim është nxjerr me shkelje procedurale dhe materiale sepse unë nuk kam përgjegjësi në këtë çështje për shkak se unë vetëm kam verifikuar formularin e plotësuar nga oficerët dhe në këtë rast kam vepruar në pajtim me rregullat; po ashtu unë kam ndërmarr të gjitha veprimet pasi që e kam njoftuar Udhëheqësin e Sigurisë dhe për këtë ekziston informata me Nr. 447/2023 e datës 10.04.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit si dhe duke u bazuar në provat e administruara të lëndës, ka konstatuar se më datë 10.04.2023 gjatë pranimit të armës MP5 nuk është vërejtur që dy fishek të saj kanë qenë të dëmtuar ndërsa pranimi është bërë kinse gjithçka është në rregull dhe për këtë rast Komisioni Hetimor sipas Raportit të datës 13.04.2023 nuk ka gjetur përgjegjës ankuesin nëse është përfshirë në këtë çështje, rrjedhimisht sipas provave materiale të lëndës, Kolegji i Këshillit, konstaton se ankuesi si Mbikëqyrës i Lartë në detyrë sipas Informatës me Nr.448/23 të datës 10.04.2023 të Mbikëqyrësit të Lartë z. K.L është njoftuar për këtë rast ndërsa sipas kësaj informate z. K.L thekson se menjëherë që është konstatuar se fishekët kanë qenë të dëmtuar është njoftuar Udhëheqësi për Siguri z. S.Sh, ndërsa informatë të ngjashme ka dhënë edhe ankuesi përmes Informatës me Nr. 447/23 të datës 10.04.2023.

Ngas provat e lëndës, shihet qartë që ankuesi ka nënshkruar Formularin Zyrtar të informimit të ndërrimit me Nr. 445/23 të datës 10.04.2023 të cilën e kanë plotësuar Zyrtarët Korrektues të cilët kanë bërë ndërrimin, respektivisht sipas përshkrimit të detyrave të punës së pozitës së ankuesit të datës 03.01.2020 në bazë të këtij përshkrimi nuk përcaktuar askund që ankuesi duhet të bëjë kontrollimin e armës sepse nuk është përgjegjësi e tij, kjo përgjegjësi nuk është paraparë as sipas rregullave të brendshme të Qendrës së Paraburgimit në Prizren. Ngase sipas Rregullave të Punës për Oficerin Korrektues në Qendrën e Paraburgimit në Prizren të datës 14.06.2022 është paraparë se: *"Oficeri i karakollit është përgjegjës për sigurimin e armës së zjarrit MP5 dhe municionit në karakollë. Oficeri i Karakollit duhet të mbikëqyrë edhe pjesën e rrethuar afër kuzhinës, ku të burgosurit e angazhuar në kuzhinë qëndrojnë kohë pas kohe dhe të monitorojë*

lëvizjet e tyre”, rrjedhimisht sipas Instruksioneve të Drejtorit për Stafin me numër reference 50/2022 të datës 11.05.2022 për Qendrën e Paraburgimit në Prizren lidhur me vendosjen e armës së gjatë të zjarrit MP5 në karakoll është përcaktuar se: “Çdo herë gjatë pranimit dhe dorëzimit të detyrës duhet verifikuar nëse arma është në gjendje të rregullt dhe municioni është i saktë në numër dhe kjo duhet vërtetuar përmes formularit adekuat i cili do të qëndroj gjatë tërë kohës në karakoll. Mbikëqyrësi i lartë kujdestar/Mbikëqyrësit kujdestar në çdo pranim dorëzim të detyrës do të verifikoj nëse forma e pranim dorëzimit të armës është e mbushur dhe nënshkruar nga oficerët dhe ta vërtetoj këtë duke e shkruar emrin dhe mbiemrin si dhe nënshkrimin e tij në formularin e njëjtë në rubrikën përkatëse”.

Kolegji i Këshillit, gjatë analizimit të këtyre rregullave të brendshme, konstaton se obligimi i mbikëqyrësit të lartë është që të bëjë verifikoj nëse forma e pranim dorëzimit të detyrës nga oficerët është bërë sipas formularit adekuat, rrjedhimisht sipas provave të lëndës ankuesi e ka bërë një gjë të tillë, ndërsa nuk ka ndonjë përgjegjësi të kontrolloj armën.

Sipas provave të lëndës, respektivisht sipas Informatës me Nr. 448/23 të datës 10.04.2023 të Mbikëqyrësit të Lartë z.K.L dhe Informatës me Nr.447/23 të datës 10.04.2023 të ankuesit, dëshmohet se ankuesi me të kuptuar rastin ka njoftuar Udhëheqësin e Sigurisë rrjedhimisht në këtë aspekt ka përmbushur detyrën e tij të përcaktuar me përshkrimin e detyrave të punës, kështu që edhe pse sipas nenit 48 paragrafi 4 nën paragrafi 4.3 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, është përcaktuar se: *“Komisioni disiplinor fillon procedurën: 4.3. me nismën e çdo anëtarit të komisionit, bazuar në fakte konkrete të provueshme për kryerjen e një shkeljeje disiplinore”*, Kolegji i Këshillit, konstaton se në rastin konkret të ankuesit Komisioni Disiplinor me rastin e inicimit të procedurës disiplinore ndaj tij nuk ka arritur të konstatoj drejtë dhe në mënyrë të saktë përgjegjësin disiplinore ndaj ankuesit respektivisht nuk ka pasur parasysh elementet e përgjegjësisë disiplinore të parapara me nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Andaj mbi bazë të këtyre dispozitave ligjore dhe mbi bazë të kësaj gjendje faktike, Kolegji i Këshillit, konstaton se Vendimi me numër KD.nr.28/2023 i datës 31.05.2023 i Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës për shqiptimin e masës disiplinore ndaj ankuesit, është në kundërshtim me nenin 45, 47, 48 dhe 50 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe dispozitave të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, si dhe i njëjti është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.5, 1.6 dhe 1.7 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhimisht Drejtori i Përgjithshëm dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës, në pajtim me dispozitivin e këtij vendimi, janë të obliguar që bëjnë zbatimin e këtij vendimi, të bëjnë shuarjen e masës disiplinore të ankuesit nga dosja personale, kështu që pretendimet e ankuesit janë të bazuara.

Po ashtu nëse palës ankuese i është ndaluar paga sipas Vendimit KD.nr.28/2023 të datës 31.05.2023 të Komisionit Disiplinor të Shërbimit Korrektues të Kosovës atëherë institucioni është i obliguar të bëjë kompensimin, ngase sipas nenit 130 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, 1përcaktohet se parashtrimi i një ankese pezullon,



sipas fuqisë së ligjit, prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidh ankesën.

Kështu që pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.895/2023, datë 28.07.2023

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Shërbimin Korrektues të Kosovës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.